

## Juria e Filmit me Metrazh të Gjatë

### The feature film jury



**Claudia Landsberger**  
Head of Jury

*Claudia Landsberger works with her company BaseWorx For Film as a creative producer in script, project development and rough-cut consulting. She is program adviser to various international film festivals such as Venice Days and Antalya Film Forum. For many years she was a member of the selection committee of the Berlinale Competition Program and the Hamburg Film Fund. She is a member of the European Film Academy. Landsberger was for two decades managing director of EYE International at the Netherlands Film Institute and co-founder and President of European Film Promotion.*

Claudia Landsberger punon me kompaninë e saj BaseWorx For Film si një producente kreative në skenar dhe zhvillimin e projektit dhe si këshilluese e rough-cut-it. Ajo është këshilltare e programeve për festivale të ndryshme ndërkombëtare si Ditët e Venecias dhe Forumin e Filmit të Antalias. Për shumë vite ajo ishte anëtare e komisionit për përzgjedhjen e Programit të Konkurrencës Berlinale dhe Fondit të Filmit të Hamburgut. Ajo është anëtare e Akademisë Europiane të Filmit. Landsberger ishte për dy dekada drejtore e EYE International në Institutin e Filmit Holandez si edhe bashkë-themeluese e Presidente e Promovimit të Filmit European.



**Elia Zaharia**  
Member of Jury

*Elia Zaharia Zog (born 8 February 1983) is an Albanian actress, former singer and wife of Leka II, Crown Prince of Albania (she is known as Her Royal Highness Crown Princess Elia of the Albanians). Educated at the Arts Lyceum Jordan Misja (Tirana), she was a Member of the "Spirit Voice" singers between 1999 and 2002. She moved later (2002) to Paris for her university studies: Dramatic Arts at the National Conservatory of Bordeaux (2002-2005), Acting at the Course Florent (2005-2007) and Scenic Acting at the Paris 8 University. During the last ten years she has realized 21 main roles in theater and cinematography.*

Elia Zaharia Zogu, është aktore shqiptare, ish këngëtare dhe bashkëshorte e Leka II, Princi i Kurorës së Shqipërisë (ajo njihet edhe si Madhëria e Saj, Princesha Elia). Edukuar në Liceun e Arteve Jordan Misja (Tiranë), ajo ishte pjesëtare e grupit muzikor "Spirit Voice" në vitet 1999 - 2002. Më vonë (2002) ajo u shpërngul në Paris për studimet e saj universitare, ku studjoi: Arte Dramatike në Konservatorin Kombëtar të Bordosë (2002 - 2005), Aktrim në Kurs Florent (2005-2007) dhe Aktrim Skenik në Universitetin e Parisit 8. Gjatë dhjetë viteve të fundit ajo ka realizuar 21 role kryesore në teatër dhe kinematografi.



**Belkis Bayrak**  
Member of Jury

*Belkis Bayrak is a Turkish filmmaker. Her first short film, The Apartment (2018) continues to screening at International Film Festivals. She is currently working on her debut feature film Gülizar. She has worked on feature film projects and film festivals. She also works as a Film Platform Director at Malatya International Film Festival (Turkey).*

Belkis Bayrak është regjimore filmi. Filmi i saj i shkurtër, The Apartment vazhdon të shfaqet në Festivale Ndërkombëtare të Filmit. Aktualisht po punon në filmin e saj debutues Gylizar. Ajo ka punuar në disa projekte filmash dhe festivale filmike. Aktualisht është Drejtore e Platformës Filmike në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit Malatya.



**Dr. Hoewig Anke**  
Member of Jury

*Anke Höwing, is a Ph.D. physician with focus on dialysis. As a cineastic art-lover she frequently attend national and international Film Festivals. Since 2004 she is head of the comitee of "Kinofest Lünen" which was founded in 1990 as a festival for german films.*

Anke Höwing, është Doktor në mjekësi, e specializuar në dializë. Si një artdashëse e kinemasë ajo frekuenton vazhdimisht Festivale të Filmit. Që nga viti 2004 është drejtuese e bordit të festivalit partner me DEA-N, "Kinofest Lünen", i krijuar në vitin 1990 si Festival për Filmin Gjermanishtfolës.



**Valmira Hyseni**  
Member of Jury

*She graduated from Faculty of Arts, in Film Directing and from University of Prishtina in Law. Since 2007 has worked in many films in Kosovo and Albania, in different production positions. Founder of ShqipFilm Production. From 2011 to 2014 was artistic director of 911 Film Festival. Board member of VAPIK (Visual Authors, Producers and Interpreters of Kosovo), member of Kosovo Producers Association.*

Është diplomuar për Regji filmi në Fakultetin e Arteve dhe për Juridik në Universitetin e Prishtinës. Që nga viti 2007 ka punuar në shumë filma në Kosovë dhe Shqipëri, në pozicione të ndryshme të produksionit. Themeluese e ShqipFilm Production. Nga viti 2011 deri në vitin 2014 ishte drejtore artistike e Festivalit të Filmit 911. Është anëtare e Bordit të VAPIK (Autorët Vizualë, Producentët dhe Interpretët e Kosovës) dhe anëtare e Shoqatës së Producentëve të Kosovës.